



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË
Fakulteti i Edukimit

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI

Pranuar me dt. 30.11.2023			
Njesia Orga	Num	Nr. Ekzëm	Vlera
	271911		

Nr.prot. 389 Dt. 24.11.2023

KËSHILLI I FAKULTETIT TË EDUKIMIT, në mbështetje të nenit 72 dhe 166 të Statutit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, në bazë të nenit 9 të Rregullores për procedurat e vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm me nr të prot 1670 të dt.28.09.2021 të UIBM, si dhe në bazë të nenit 22 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.11.2023 në kuadër të kompetencave ligjore, merr këtë:

VENDIM

I. MIRATOHET Raporti i Komisionit të Ankesave, me nr. të prot. 377, të datës 20.11.2023 lidhur me ankesën e paraqitur me nr.prot. 360 datë 14.11.2023 të parashtrueses Yllka Imeri.

II. HIDHET poshtë si e pabazuar ankesa e parashtrueses Yllka Imeri me nr. të prot. 360 të datës 14.11.2023, ndaj raportit të Komisionit vlerësues me nr. prot. 291, të datës 30.10.2023, për konkursin me nr. të prot.2067 datë 10.10.2023 publikuar në Buletinin nr.4 datë 09.11.2023.

III. Raporti i Komisionit vlerësues me nr. prot.291, datë 30.10.2023, është në harmoni me Ligjin mbi Arsimin e Lartë, 04/L-037, Statutin e Universitetit “Isa Boletini”, Rregulloren nr.prot. 1670 datë 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë.

IV. Mbetet në fuqi raporti i Komisionit vlerësues me nr.prot. 291 datë 30.10.2023 dhe i dërgohet për miratim Senatit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë.

A R S Y E T I M

Komisioni vlerësues me datë 30.10.2023 ka përpiluar raportin vlerësues për pozitën VI/4 një mësimdhënës për lëndët: Gjuhe shqipe III (Sintaksa) me metodologji dhe Metodologji e gjuhës shqipe.

Sa i përket ankesës së kandidatës Yllka Imeri, komisioni i ankesave ka verifikuar dosjen e kandidatës sipas kërkesave të konkursit dhe më pas ka konstatuar se:

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/515516 – lokali 7

Sa i përket pretendimeve të ankueses për: "Trajtim joprofesional dhe jo në përputhje me ligjin", komisioni konstaton se: Sipas Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, precizohet në nenin 12 se "Për çështjet që nuk janë rregulluar me këtë rregullore, me analogji zbatohen dispozitat e Statutit të UIBM-së dhe dispozitat e rregullores për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik me nr. të prot. 1667, datë 28.09.2021".

Prandaj për përbërjen e komisionit, Këshilli i Fakultetit të Edukimit ka respektuar pikën 6 të nenit 10 të rregullores nr. prot. 1667, datë 28.09.2021, e cila specifikon se: "Në komisione vlerësuese duhet të jenë së paku dy (2) anëtarë nga fusha e ngushtë me lëndët për të cilat është shpallur konkursi"; dhe ka respektuar pikën 10 të nenit 16 të rregullores nr. prot. 1667, datë 28.09.2021, e cila specifikon se: "Anëtarët e komisionit vlerësues mund të jenë edhe nga Universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit. Në këtë rast, së paku një (1) anëtar i komisionit është i brendshëm, nga Universiteti. Në rastet kur komisioni vlerësues ka dy anëtarë të jashtëm, anëtari i brendshëm me automatizëm është kryetar i komisionit".

Sipas konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime të personelit akademik në Fakultetet e Universitetit "Isa Boletini" nr. prot. 2067, datë 10.10.2023, në nënpikën d) pika XIII, specifikisht kërkohet që kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente: "Kopjet e diplomave (bachelor, master/magjistraturë, doktoratë) të vërtetuara me vulë origjinale të noteri për secilën pozitë që aplikon".

Duke u mbështetur në këto që u tha më lartë, pretendimet e ankueses se kryetarja e komisionit të kërkojë dosje të mëhershme, nuk qendron.

Andaj si pikë e lartëcekur e ankesës është e pabazuar.

Prandaj, Këshilli i Fakultetit të Edukimit pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit të Ankesave, dhe të cekurave si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti iu dërgohet:
Fakultetit
Parashtrueses së ankesës
Zyrës për çështje akademike
Arkivës së Fakultetit

Kryesuesja e Këshillit të

Prof. as. dr. Samire Bllaca Balaj



UNIVERSITETI I MITROVICËS
"ISA BOLETINI"
FAKULTETI I EDUKIMIT

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË FAKULTETI I EDUKIMIT			
Pranuar me dt.		20/11/2023	
Njesia organ.	Numer	Nr. Ekzempl.	Vlera
	377		

Nr. Prot. _____ Dt _____

Në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Edukimit me nr. Prot. 254 të datës 20.10.2023 është formuar Komisioni i ankesave për kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime të personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Isa Boletini" të datës 10.10.2023 me Nr. Prot. 2067. Komisioni është mbledhur me datën 20.10.2023 për të shqyrtuar ankesën e Yllka Imeri e paraqitur me Nr. Prot. 360 të datës 14.11.2023, pas shqyrtimit të dokumentacionit komisioni i lartëcekur përpiloi këtë:

R A P O R T

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** Ankesa e parashtruar me Nr. Prot. 360 të datës 14.11.2023 nga kandidatja Yllka Imeri.

Arsyetim

Komisioni vlerësues me datë 30.10.2023 ka përpiluar raportin vlerësues për pozitën VI/4 një mësimdhënës për lëndët: Gjuhë shqipe III (Sintaksa) me metodologji dhe Metodologji e gjuhës shqipe.

Sa i përket ankesës së kandidatës Yllka Imeri komisioni i ankesave ka verifikuar dosjen e kandidatës sipas kërkesave të konkursit dhe më pas ka konstatuar se:

Sa i përket pretendimeve të ankueses për: "Trajtim joprofesional dhe jo në përpukthje me ligjin", komisioni konstaton se: Sipas Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, precizohet në nenin 12 se "Për çështjet që nuk janë rregulluar me këtë rregullore, me analogji zbatohen dispozitat e Statutit të UIBM-së dhe dispozitat e rregullores për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik me Nr. Prot. 1667, dt. 28.09.2021".

Prandaj për përbërjen e komisionit, Këshilli i Fakultetit të Edukimit ka respektuar pikën 6 të nenit 10 të rregullores Nr. Prot. 1667, dt. 28.09.2021, e cila specifikon se: "Në komisione vlerësuese duhet të jenë së paku dy (2) anëtarë nga fusha e ngushtë me lëndët për të cilat është shpallur konkursi"; dhe ka respektuar pikën 10 të nenit 16 të rregullores Nr. Prot. 1667, dt. 28.09.2021, e cila specifikon: "Anëtarët e komisionit vlerësues mund të jenë edhe nga universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit. Në këtë rast, së paku një (1) anëtar i komisionit është i brendshëm-nga Universiteti. Në rastet kur komisioni vlerësues ka dy anëtarë të jashtëm, anëtari i brendshëm me automatizëm është kryetar i komisionit".

Sipas konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime të personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Isa Boletini" Nr. Prot. 2067, dt 10.10.2023, në nën pikën d) pika XIII, specifikisht kërkohet që kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente: "Kopjet e diplomave (bachelor, master/magjistraturë, doktoratë) të vërtetuara me vulë origjinale te noteri për secilën pozitë që aplikon".

Duke u mbështetur në këto që u tha më lartë, pretendimet e ankueses se krytarja e komisionit të kërkojë dosje të mëhershme, nuk qëndron.

Andaj si pikë e lartëcekur e ankesës është e pabazuar.


Komisioni i ankesave i propozon Këshillit të Fakultetit, që ankesa në fjalë të refuzohet si e pabazuar.

Komisioni:

Prof. dr. Qerim Selimi, Kryetar



Ass. Hatixhe Gashi, Anëtare



Ass. Ylli Hashani, Anëtar



Raporti iu dërgohet:

Arkivës së Fakultetit

Këshillit të Fakultetit

Parashtrueses së ankesës